

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA MULLA KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 72348/11)

VENDIM

STRASBURG

6 korrik 2023

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Mulla kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur si një Komision, i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e Përkohshme e Seksionit,*

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 15 qershor 2023;

Jep vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja nisi me kërkesën kundër Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 10 nëntor 2011.

2. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u njoftua për kërkesën.

FAKTET

3. Detajet e kërkesës dhe informacioni përkatës për aplikimin gjenden në tabelën bashkëlidhur.

4. Kërkuesi u ankua për kohëzgjatje të tepërt të procesit civil. Gjithashtu, ai bëri edhe ankesa të tjera, sipas parashikimeve të Konventës dhe Protokolleve të saj.

LIGJI

I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

5. Kërkuesi u ankua se kohëzgjatja e procesit civil konkret nuk ishte në përputhje me parashikimin për “afat të arsyeshëm”. Ai u mbështet në nenin 6 § 1 të Konventës.

6. Në çështjen konkrete, procesi i cili zgjati për jo më pak se shtatë vjet, kishte të bënte me një çështje të thjeshtë: anulimin e procesit të shitjes dhe të privatizimit. Kohëzgjatja iu atribua rikthimit të çështjes për gjykim dhe vonesave në Gjykatën e Apelit (për dy vjet), dhe në Gjykatën e Lartë (për dy vjet). Procesi nisi në Gjykatën e Rrethit Vlorë më 21 nëntor 2003 dhe zgjati deri më 18 maj 2011, kur Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e kërkesës së ankuesit për padrejtësi në proces. Qeveria nuk i kundërshtoi këto parashtrime të kërkesës, në lidhje me kohëzgjatjen e procesit.

7. Gjykata përsërit se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të çështjes dhe referuar kritereve të mëposhtme: kompleksitetit të çështjes, sjelljes së kërkesës dhe të autoriteteve përkatëse dhe çfarë ishte në rrezik për kërkesuesin në mosmarrëveshje (shih *Frydlender*

kundër Francës [DHM], nr. 30979/96, § 43, GJEDNJ 2000-VII; *Gazsó kundër Hungarisë*, nr. 48322/12, § 15, 16 korrik 2015; dhe *Topallaj kundër Shqipërisë*, nr. 32913/03, § 75, 21 prill 2016).

8. Në çështjet kryesuese, *Luli dhe të Tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, 1 prill 2014, dhe *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010, Gjykata tashmë ka konstatuar një shkelje, në lidhje me problematika të ngjashme me ato në çështjen konkrete.

9. Pasi shqyrtoi materialet e dorëzuara pranë saj, Gjykata nuk ka gjetur fakte ose argumente që justifikojnë kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit në nivel vendës. Duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore për lëndën, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete, kohëzgjatja e procesit ishte e tepërt dhe nuk respektonte kërkesën për “afat të arsyeshëm”.

10. Për këtë arsye, kjo ankesë është e pranueshme dhe konstaton një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

II. ANKESA TË TJERA

11. Kërkuesi u ankua edhe në mbështetje të nenit 13 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 për mungesë të mjeteve efektive dhe shkelje të së drejtës së tij ndaj pronës. Duke pasur konsideratë për faktet e çështjes, parashtrimet e palëve dhe konstatimet e mësipërme, Gjykata vlerëson se e ka shqyrtuar çështjen kryesore ligjore në kërkesën konkrete. Në këtë mënyrë, ajo konstaton se nuk është e nevojshme që të japë një vendim të veçantë për to (krahaso *Qendrën për Burime Juridike në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014, dhe *Habilaj kundër Shqipërisë* [Komisioni], nr. 2480/10, § 14, 15 Shtator 2022).

III. ZBATIM I NENIT 41 TË KONVENTËS

12. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

13. Pasi ka shqyrtuar dokumentet në zotërimin e saj dhe praktikën e saj gjyqësore (shih, veçanërisht, *Luli dhe të Tjerë*, cituar më sipër, dhe *Mishgjoni*, cituar më sipër), Gjykata e vlerëson të arsyeshme që të akordojë shumën e përcaktuar në tabelën bashkëlidhur.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *E deklaron* ankesën në lidhje me kohëzgjatjen e procesit, në mbështetje të nenit 6 të Konventës, të pranueshme, dhe *vendos* se nuk është e nevojshme që të shqyrtojë në mënyrë të veçantë ankesat e tjera të drejtuara në mbështetje të praktikës gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës (shih tabelën bashkëlidhur);

2. *Vendos* se kjo kërkesë konstaton një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procesit civil;

3. *Vendos*:

a. se Shteti përgjegjës duhet t’i paguajë kërkuessit, brenda tre muajve, shumën e përcaktuar në tabelën bashkëlidhur, të konvertuara në monedhën e Shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b. se nga përfundimi i tre muajve përmendur më sipër deri në shlyerje, për shumën e mësipërme duhet të paguhet interes i thjeshtë në normën e barabartë me normën marginale huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonësës së pagesës plus tre për qind pikë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 6 korrik 2023, sipas rregullit 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDESRREGJISTRAR I PÛRKOHSHËM

Ioannis Ktistakis
KRYETAR

SHTOJCË
LISTA E KËRKUESVE QË PARAQESIN ANKESAT NË MBËSHTETJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS
(MOSEKZEKUTIM OSE EKZEKUTIM I VONUAR I VENDIMEVE VENDESE)

Nr. i kërkesës Data e dorëzimit	Emri i kërkesit Viti i lindjes	Nisja e procesit ose data e hyrjes në fuqi e Konventës për Shqipërinë (2 tetor 1996)	Përfundimi i procesit	Kohëzgjatja në total Nivelet e juridiksionit	Ankesa të tjera sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar	Shuma akorduar për dëm jopasuror dhe kostot dhe shpenzimet për kërkes (në euro) ¹
72348/11 10.11.2011	Grigor MULLA 1933	21.11.2003	18.5.2011	7 vjet dhe 5 muaj, dhe 28 ditë 4 nivele të juridiksionit	Neni 13: mungesë e mjetit efektiv në ligjin vendës për t'u ankuar për kohëzgjatjen e tepërt të procesit. Prot. 1, neni 1 – ndërrhyrja në gëzimin e paqte të pasurive	1,700

¹ Plus çdo taksë që mund t'u tarifohej kërkesve.